



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 283/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjez. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Nas System" SH.P.K.-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "GO-X" SH.P.K. dhe "K-ING" SH.P.K. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ujëmatës zonal për Regjionin Gjilan, Kamenicë dhe Viti", me numër të prokurimit: 18-8232-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KRU "Hidromorava". SH.A., më datën 26.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Nas System" SH.P.K.-Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me ujëmatës zonal për Regjionin Gjilan, Kamenicë dhe Viti", me numër të prokurimit: 18-8232-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KRU "Hidromorava". SH.A.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Furnizim me ujëmatës zonal për Regjionin Gjilan, Kamenicë dhe Viti", me numër të prokurimit: 18-8232-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU "Hidromorava". SH.A.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Nas System” SH.P.K. Gjilan, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:25.10.2018

Afat i fundit për dorëzimin e ofertave me dt:08.11.2018

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dt: 19.02.2019

Njoftimi me letër standarde për tenderues të eliminuar/ pasuksesshëm dt: 19.02.2019

Kërkesë për rishqyrtim dt: 25.02.2019

Vendimi i AK-se lidhur me kërkesën për rishqyrtim (hera e dytë) dt: 28.02.2019

Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dt: 21.05.2019

Vendimi i AK-se lidhur me kërkesën për rishqyrtim (hera e tretë) dt: 27.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim nga “Toifor” me dt:05.06.2019.

Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor ka marr vendim me të cilin e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Nas System” SH.P.K.-Gjilan, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.06.2019 me nr. 283/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “GO-X” SH.P.K. dhe “K-ING” SH.P.K. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me ujëmatës zonal për Regionin Gjilan, Kamenicë dhe Viti”, me numër të prokurimit: 18-8232-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU “Hidromorava” SH.A., duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28, dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 11.06.2019 ka autorizuar

ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesnë raportin e dt:17.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:Lidhur me pretendimin OE ankues se OE i rekomanduar për kontrate sa i përketujëmatësve:

- Ujëmatësi zonal pulsativ i gatshëm për AMR, tip Woltman, dizajn kompakt, i dedikuar për matje të rrjedhjes me shumice të ujit të ftohët tëpijshëm tëkërkuar në FDT dhe në specifikim teknik tëdetyrueshëm. Ujëmatësi zonal duhet të jetë i pajisur me njësi për dhënie të pulseve (pulse output unit) dhe me veçori për lexim automatik tëharxhimit, ujëmatësi duhet tëketë shenje CE si shenje e konfirmimit të BE si dhe shenjen plotësuese M si shenje e metrologjisë.

Eksperti teknik, lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se pas ekzaminimit të dosjes së tenderit dhe specifikave teknike të kërkuara vlerëson se OE i rekomanduar për kontrate “GO-X”SH.P.K. dhe K-ING” SH.P.K. i ka përmbush specifikimin teknik tëdetyrueshëm për ujëmatës të cilat janë në FTD.

OE i rekomanduar për kontrate ka aplikuar me ujëmatës të modelit: tip Woltman, katalogun të cilin e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë shihet qartë se ujëmatësi e ka shenjen “CE” si shenje e konfirmimit të BE si dhe shenjen plotësuese “M” si shenje tëmetrologjisë, po ashtu nuk vërehet numri serik i ujëmatësit që identifikon ujëmatësin. Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate i ka të paraqitura tëgjithëujëmatësit të paraqitur nëkatalogët të cilat i ka të prezantuara sipas kërkesës së kërkuar në DT.

Përgjigjet në pretendimet ankimore që OE ankues, në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë të cilat nuk i ka plotësuar specifikat teknike të detyrueshme për Valvula Shiber të cilat janë të kërkuara në DT nga Autoriteti Kontraktues, me rastin e parashtrimit.

Eksperti teknik, lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoriteti Kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 konkretisht (nenin 28 specifikimin teknik) të LPP-së, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar Valvulat Shiber sipas standardit: EN 558 po është dashur të prezantoj sipas standardit DIN 3476 dhe DIN 30677 tëkërkuar në DT se nuk janë të njëjta. Kjo nuk qëndron sepse këto dy standarde EN dhe DIN nderlidhen në mes vete.

PN 10-16 DN 40-400

EN 558-1

- Prodhuar sipas kërkesave të EN 1074 dhe EN 1171.
- Certifikuar dhe shënuar nga trupi i tretë si prodhim mbikëqyrësi.

- EPOXY pluhur me cilësi të lartë të trupit dhe mbulesës se veshur (bashkim i ngjitur), trashësia e veshjes DFT (Desing For Testing) min.250 mikron, porositet zero (testuar me 3000V),ndikim të lartë rezistence dhe ndërlidhje sipas standardit DIN 30677 dhe DIN 3476.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar Valvula sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktues në DT.

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, Eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues është e pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues njoftimi mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues për dhënie të kontratës.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iOE-së z. Salihudekloroj:Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit ashtu siç nuk jemi pajtuar me vendimin e Autoriteti Kontraktues, kjo është hera e 3-të qe vjen në OSHP, 2 here kemi qenë fitues dhe OE të tjera na janë ankuar dhe tani jemi pala ankuese vet. Vendimi i Autoriteti Kontraktues mendoj qe është diskriminues sepse na kanë eliminuar për diçka qe nuk është në DT dhe nuk është kriter por janë bazuar me mostren e produktit, sa i përket vendimit ne kemi paraqit kërkesë për rishqyrtim dhe nuk është marr parasysh nga Autoriteti Kontraktues dhe kemi bërë ankesë ne OSHP. Sa i përket mendimit të ekspertit shqyrtues, eksperti nuk është marr me të 3 pretendimet tona ankimore por vetëm me 2. ne pretendojmë se të 3 pikat përbejë shkelje. Pretendimi pare është se OE i shpallur fitues nuk ka dorëzuar specifikim të detajuar por vetëm katalogë të cilat bien ndesh mes veti për dimensionet qe janë kërkuar 32, 40 dhe 50 ka ofruar 3 katalogë të ndryshme me të cilat bie ndesh mes vete edhe ato. Ne mendojmë qe është bere shkelja e nenit 69 të LPP-së. Pretendimi 2-të specifikimet teknike ku thotë” ujëmatës zonal pulsativ i gatshëm tip:Woltman OE fituese nuk e ka ofruar Tip:Woltman por ka ofruar Multi Jet. Për këtëmendojmë qe është shkel neni 28 i LPP-së. Për këtë

dëshmoj me prova panelit shqyrtues ku modeli Woltman dhe Multi Jet ku janëkërkuarsipas DT-së . Pretendimi i 3-të“valvulat Shiber” të cilat duhet të jenë konform mestandardin DIN 3476 dhe DIN 30677, OE i shpallur fitues nuk ka ofruar “Valvula Shiber” sipas standardit qe është kërkuar ne aneksin 1. Mendimi i ekspertit ne këtë është bazuar në mendiminparaprak të cilin është bërëkundër nesh e qe nuk ka tëbëjë fare me këto pretendime tona, sa i përket standardit EN 558 i cili thotë se është relevant me standardin e kërkuar 30677 kjo nuk qëndron sepse Standardi EN: 558 seria 14 të cilin OE i shpallur e ka ofruar nuk është standard relevant me DIN: 3476 dhe DIN: 30677 por me standardin 3202 edhe për këtë ju ofroj dëshmi, sa i përket standardit EN: 1074 te produkti ofruar nga OE nuk i plotëson fare kërkesat e kërkuara ofroj dëshmi edhe për këtë. Mendojmëse janë bërë shkelje të nenit 7 , 28 dhe 69 të LPP-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesiiAK-së z. Idrizideklarojë:Unë sa i përket ankesës me nr 283/19 me ujëmatës zonal për Gjilan dhe Viti qëndroj pas vendimit të ekspertit teknik dhe mbas opinionit te komisionit te vlerësimit.

Gjatë prezantimit në seance Eksperti shqyrtues Teknik z. Fejza deklarojë: Edhe unë si ekspert është hera e 2-të qe merrem me këtë lëndë dhe pas analizës ne aspektin teknik të gjitha kriteret janë plotësuar nga OE i rekomanduar për kontrate andaj qëndroj prapa ekspertizës time.

Standardi EN është injëjti standard edhe me herët kam dhen tënjëjtin mendim qe ne nuk mund te bëjmë devijime teknike standardet janë Evropiane janë nëpërputhshmëri të plotë dhe lehtë të verifikueshme.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga ju qe të merren parasysht faktet dhe dëshmitë tona dhe ta ktheni në rivlerësim apo ne anulim këtëAktivitet prokurimi.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesii AK-së deklaroj: Kërkojë të hedhet poshtë ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, gjet seancës për shqyrtim kryesor lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontrate sa i përket ujëmatësve:

- Ujëmatësi zonal pulsativ i gatshëm për AMR, tip Woltman, dizajn kompakt, i dedikuar për matje te rrjedhjes me shumice të ujit të ftohët të pijshëm të kërkuar ne FDT dhe ne specifikim teknik të detyrueshëm. Ujëmatësi zonal duhet të jetë i pajisur me njësi për dhënie të pulseve (pulse output unit) dhe me veçori për lexim automatik të harxhimit, ujëmatësi duhet të ketë shenje CE si shenje e konfirmimit të BE si dhe shenjen plotësuese M si shenje e metrologjisë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik konstaton se OE i rekomanduar për kontrate “GO-X”SH.P.K. dhe K-ING” SH.P.K. i ka përmbush specifikimin teknik të detyrueshëm për ujëmatës të cilat janë në FTD.

Sepse OE i rekomanduar për kontrate ka aplikuar me ujëmatës të modelit: tip Woltman, katalogun të cilin e ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë shihet qartë se ujëmatësi e ka shenjen “CE” si shenje e konfirmimit të BE si dhe shenjen plotësuese “M” si shenje të metrologjisë, po ashtu nuk vërehet numri serik i ujëmatësit që identifikon ujëmatësin. Po ashtu OE i rekomanduar për kontrate i ka të paraqitura të gjithë ujëmatësit të paraqitur në katalogët të cilat i ka të prezantuara sipas kërkesës së kërkuar në DT.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoriteti Kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 59 konkretisht (nenin 28 specifikimin teknik) të LPP-së, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar Valvulat Shiber sipas standardit: EN 558 po është dashur të prezantoj sipas standardit DIN 3476 dhe DIN 30677 të kërkuar në DT se nuk janë të njëjta. Paneli shqyrtues konform ekspertit teknik konstaton se kjo nuk qëndron sepse këto dy standarde EN dhe DIN ndërlidhen në mes vete.

PN 10-16 DN 40-400

EN 558-1

- Prodhuar sipas kërkesave të EN 1074 dhe EN 1171.
- Certifikuar dhe shënuar nga trupi i tretë si prodhim mbikëqyrësi.
- EPOXY pluhur me cilësi të lartë të trupit dhe mbulesës së veshur (bashkim i ngjitur), trashësia e veshjes DFT (Desing For Testing) min.250 mikron, porositet zero (testuar me 3000V), ndikim të lartë rezistence dhe ndërlidhje sipas standardit DIN 30677 dhe DIN 3476.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar Valvula sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues në DT.

Paneli shqyrtues nga sqarimet e dhëna si më lart konstaton se ekzaminimivlerësimi dhe krahasimi i ofertave është bërë në pajtim me nenin 59 LPP-së dhe se pretendimet e ankuesi për shkelje të këtyre dispozitave janë të pa qëndrueshme.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 dhe 28 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave i është përmbajtur të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –KRU “Hidromorava”.SH.A.- Gjilan,
- 1x1 OE–”Nas System”SH.P.K.- Gjilan
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

